



Klubi i Futbollit Ballkani SH.P.K.

“ FC Ballkani ” - Suharekë

Raporti i auditorit të pavarur dhe
pasqyrat financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

Prishtinë, më 28 shkurt 2024

Përmbajtja:

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR	7
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	8
SHËNIMET NË PASQYRAT FINANCIARE	9-13

"Alb Audit" SH.P.K.

Telefon.: +383 (0) 44 121 655

Email: albaudit@hotmail.com

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Menaxhmentin e Klubi i Futbollit Ballkani SH.P.K. - FC Ballkani

Opinionit i Auditorit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Klubi i Futbollit Ballkani SH.P.K. "FC Ballkani" - Suharekë, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2023, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar në këtë datë, dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

- Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Klubi i Futbollit Ballkani SH.P.K. "FC Ballkani" – Suharekë, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare më 31 dhjetor 2023, si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar, në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit (SKK) dhe Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM-të).

Çështjet Kryesore të Auditimit

Auditimi përfshinë ekzaminimin në bazë të testeve të dhënave në mbështetje të shifrave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura si dhe nevojën e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Përgjegjësitë e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre Pasqyrave Financiare në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit (SKK) dhe Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM-të). Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant; për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare; të jenë të liruar nga gabimet materiale, nga mashtrimi apo nga gabimi; zgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit; bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një mendim mbi këto Pasqyra Financiare bazuar në auditimin tonë. Ne zhvilluam auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat etike dhe të planifikojmë e zhvillojmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme mbi atë se a janë Pasqyrat Financiare të liruar nga gabimet materiale. Auditimi përfshinë zbatimin e procedurave që të arrijmë dëshmi audituese rreth shumave dhe shpalosjeve në Pasqyrat Financiare.

"Alb Audit" SH.P.K.

Telefon.: +383 (0) 44 121 655

Email: albaudit@hotmail.com

Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të Pasqyrave Financiare, qoftë nga gabimi apo nga mashtrimi. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr në konsiderim kontrollin e brendshëm relevant

Përgjegjësia e audituesit të pavarur

Përgjegjësia jonë është të japim një mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin e bërë. Objektivat tona gjatë auditimit janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshinë opinion tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikoj gjithmonë një anomali materiale kur ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose se bashku, pritet në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

"Alb Audit" Sh.P.K.

Remzi Jashar, Auditor Ligjor

Shkurt, 2024



Klubi i Futbollit Ballkani SH.P.K. "FC Ballkani"
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

Pasuritë	Shënimi	31.12.2023	31.12.2022
Asetet aktuale			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	3	252,949	339,852
Pasuritë tjera afatshkurta II/a		2,467,150	1,209,495
Llogarite e arketueshme nga transferimi i lojtarëve		-	-
Llogarite e arketueshme nga grupet/ subjektetet e nderlidhura		-	-
Llogarite e arketueshme (te tjera)		-	-
Parapagimet		-	-
Kerkesa per tatim te paguar me teper		-	FALSE
Kerkesat e tjera		-	-
Totali I asetëve aktuale		2,720,099	1,549,347
Pasurite (Pasurite e qëndrueshme të trupëzuara)			
Pasurite e paprekshme - Investimet		72,034	75,826
Pasurite e paprekshme – te tjera		-	-
Llogarite e arketueshme (te tjera)		-	-
Pasuritë e paprekshme-patrupzuara			
Invesimet afatgjate		-	-
Pasurite e tjera		-	-
Totali i pasurive themelore		72,034	75,826
Totali I asetëve		2,792,133	1,625,173
Detyrimet dhe ekuiteti			
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>			
Detyrimet tjera afatshkurta/pagat			
Tatimi ne paga dhe kontributet			
Obligimet per tatimet tjera		-	-
Tatimi mbi fitim i pagueshëm		-	-
Obligimet ndaj furnitorve		-	-
Detyrimet tjera afateshkurtëra		330,964	567,605
Totali I detyrimeve aktuale		330,964	567,605
Detyrimey afatgjate			
Huatë afatëgjate		-	-
Detyrimet e tjera jokurente		-	-
Totali i detyrimeve afatgjate		-	-
Totali i Detyrimeve		330,964	567,605
Detyrimet tjera/Te hyrat e shtyera			
Kapitali dhe rezervat:			
Kapitali aksionar		150,000	143,608
Dividenta e paguar		1,003,005	(1,828,406)
Fitimi/humbja e vitit afarist		1,308,163	2,742,366
Gjithsejt ekuitetit		2,461,168	1,057,568
GJITHSEJ DETYRIME DHE EKUITET		2,792,133	1,625,173

Shënimet shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare jane te aprovuara nga Menaxhmenti dhe jane autorizuar nga drejtori
 25.03.2024

Drejtori

Arsim Kabashi



Drejtori Financiar/Kontabilist I Certifikuar

Sylejman Vitia

Të ardhurat	Shënimi	31.12.2023	31.12.2022
Te hyrat nga donacionet	4	925,518	896,073
Te hyrat nga sponsorizimet dhe reklamat, FFK, UEFA	4	4,176,715	4,192,084
Te hyrat nga shitjet e biletave	4	132,425	159,232
Të hyra tjera operative	4	629,286	10,051
Totali I te ardhurave		5,863,944	5,257,440
Shpenzimet operative			
Shpenzimet Materjale	6-8	(1,093,275)	(599,826)
Shpenzimet e perfitimit te punonjesve	5	(2,256,414)	(1,889,537)
Shpenzimet e Zyrës & Administratës		-	-
Zhvlersimi i mjeteve themelore		(3,791.28)	-
Totali I shpenzimeve operative		(3,353,480)	(2,489,363)
Fitimi/Humbja operative			
		2,510,463	2,768,077
Tregtimi(shitja) I lojtarve		-	-
Amortizimi i aktiveve jo-Materiale Fikse (regjistrimet e lojtarve)		-	-
Zhvlerësimi i aktiveve jo-Materiale (regjistrimet e lojtarve)		-	-
Fitimi / humbja nga shitja e lojtarve		-	-
Kostoja e regjistrimit te lojtarve (dukë përfshirë edhe agjentet e pakapitalizuar / tarifat e ndërmjetme dhe kredite)		-	-
Te ardhurat ne dispozicion nga regjistrimet e lojtarve (dukë përfshirë të ardhurat e kredisë)		-	-
Totali nga shitja e lojtarve		-	-
Të ardhurat Financiare		-	-
Kostot financiare		-	-
Të dala të tjera financiare		-	-
Fitimet e këmbimit valutor neto / (Humbjet)		-	-
Te ardhurate neto financiare / shpenzimet		-	-
Fondet e bartuara		-	-
Fitimi ose humbja para taksave		2,510,463	2,768,076.53
Tatimi në fitim		-	-
Fitimi/Humbja neto për vitin		2,510,463	2,768,076.53

Shënimet shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Klubi i Futbollit Ballkani SH.P.K. "FC Ballkani"
Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023

(Vlerat në Euro)

		31.12.2023	31.12.2022
Të hyrat nga Donacionet	4	5,731,519	5,098,208
Te hyrat nga shitjet e biletave	4	132,425	159,232
Te hyrat e shtyera		-	-
Humbja nga shitja e pasuris jo qarkulluese		-	-
Shpenzimet e interesit		-	-
Rritja/zvoglimi ne stoqe		-	-
Rritja/zvoglimi ne te arketueshmet		(1,257,655)	(981,495)
Rritja/zvoglimi ne te pagueshmet		568,898	421,858
Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet		5,175,186	4,697,803
Daljet e Parasë:			
Shpenzimet e Pagave	5	(2,256,414)	(1,889,537)
Shpenzimet e Aktiviteteve & Operative	6-8	(1,273,773)	(671,987)
Obligimet rrjedhse		(292,403)	15,120
Rrjedhja neto e paras nga aktiviteti operativ		1,352,596	2,151,398
Tatime te paguara		(237,200)	(168,200)
Dividenta e paguar		(1,202,300)	(1,828,406)
Rrjedhja neto e paras nga aktivitetet investuese		-	67,783
Arketimet e parase nga shitja e lojtarve te regjistruar		-	-
Investimet afatgjata		-	(75,826)
Pagesat me para te gatshme per huazimet ndaj aksionarve/personave te nderlidhur		-	-
Kapitalit akcionar		-	143,608
Rrjedhja neto e paras nga aktivitetet investuese		-	67,783
Rrjedhja neto e paras nga aktivitetet financiare			
Emetimi i kapitalit akcionar		-	-
Te hyrat nga Donatoret		-	-
Te hyrat nga Shitjet		-	-
Rrjedhja e paras nga aktivitetet financiare		-	-
Rritja/zvoglimi i paras se gatshme për periudhen		(86,904)	222,575
Paraja e gatshme ne fillim te periudhes		339,852	117,277
Paraja e gatshme ne fund periudhes		252,948	339,852

Shënimet shoqëruese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

1.INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Klubi i Futbollit "Ballkani" Sh.p.k. ("Kompania") është themeluar si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Kompania është themeluar më 15.12.2017 dhe vepron në përputhje me dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare" nr. 06 / L-016, Ligji "Për Regjistrin Tregtar" nr. 02 / L-54, me numër regjistrimi të biznesit 810079196. Adresa e operimit të kompanisë është në rrugën Stadiumi i Qytetit në Suharekë, Republika e Kosovës.

Adresa e operimit të kompanisë është në rrugën Stadiumi i Qytetit në Suharekë, Republika e Kosovës.

Pronarët: Arsim Kabashi, Pozita-Drejtor i Shoqërisë, Kryesues dhe Anëtar i Bordit Drejtues.

Aktiviteti kryesor është:

9312 Aktivitetet e klubeve sportive	Primarë
9319 Aktivitetet e tjera sportive	Sekondarë
9609 Aktivitetet e tjera p.k.t.	Tjera
9313 Palestra e fitnesit	Tjera
7311 Agjencitë për publicitet	Tjera
7312 Publiciteti përmes mediave	Tjera
8551 Arsimi për sporte dhe rekreacion	Tjera
9311 Funksionimi i objekteve sportive	Tjera

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

2.1 Baza e matjes

Pasqyrat financiare për Klubin e Futbollit "Ballkani" Sh.p.k. janë përgatitur në bazë të matjeve të përcaktuara me Standardet Kosovare të Kontabilitetit (SKK), Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM-të) dhe ligjet në fuqi në Kosovë për secilin lloj të pasurisë, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë.

2.2 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit dhe Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM-të).

2.3 Baza e ergatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.4 Monedha funksionale dhe raportuese

Monedha raportuese e Organizatës është Euro, monedha që është ligjore në territorin e Kosovës.

2.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë janë konsideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse. Klubi i Futbollit "Ballkani" Sh.p.k. operon me llogaritë bankare të hapura në BKT.

2.6 Transaksionet në monedhë të huaj

Në fund të çdo periudhe të raportimit, zërat monetarë të mbajtur në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me normat që mbizotërojnë në atë datë. Zëra jo-monetarë të mbajtur me vlerë të drejtë që janë të shprehur në monedhë të huaj konvertohen me normat mbizotëruese në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zëra jo-monetarë që janë matur në terma të kostos historike në monedhë të huaj nuk ri-konvertohen.

2.7 Asetet fikse të trupëzuara

Asetet fikse të trupëzuara paraqiten me koston minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të njohur nga zhvlersimi / amortizimi. Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të zvoglojë koston ose vlerësimin e aseteve përveq tokës dhe pronave në ndërtim e sipër, mbi jetën e tyre të vlerësuar të përdorimit duke përdorur metodën lineare, në bazë të mëposhtme:

Ndërtesat	5% në vit
Pajisjet dhe makineria e rendë	10% në vit
Pajisjet dhe makineria	20% në vit

Asetet e marra me qira zhvlerësohen për jetën e tyre të dobishme ekonomike të pritshme mbi bazën e njejtë si Asetet në pronësi ose, në periudhë më të shkurtër, gjatë afatit të qirasë përkatëse. Fitimi ose humbja që rrjedh ose nga shitja ose dalja jashtë përdorimit të një aktivi përcaktohet si diferencë midis të ardhurave të shitjes dhe vlerës kontabël të aktivitetit dhe njihet në të ardhura.

2.8 Asetet Jo-materiale fikse – lojtarët

Transferimi dhe shpenzimet e rastit që lidhen me blerjen e lojtarëve të regjistruar kapitalizohen si aktive fikse të patrupëzuara.

Këto kosto janë amortizuar plotësisht, në këste të barabarta vjetore, gjatë periudhës së kontratave të lojtarëve respektiv.

Nuk përfshihen shumat e lojtarëve brenda klubit. Kur rinegociohet një kontratë, së bashku me shpenzimet e reja që lidhen me zgjerimin e kësaj kontrate, duhet të amortizohen gjatë afatit të kontratës së re.

Çdo tarifë transferimi e pagueshme si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve në të ardhmen duhet të kapitalizohet, kur është e mundur që një ngjarje e tillë do të ndodhë.

Regjistrimet e lojtarëve duhet të zhvlerësohen, kur vlera kontabël neto tejkalon shumën e rikuperueshme përmes përdorimit ose shitjes.

2.9 Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare fillimisht regjistrohen në shumën e arkëtueshme kundrejt shitjes së produkteve. Më pas, të arkëtueshmet tregtare shprehen me koston e tyre nominale minus kompensimin për borxhet e dyshimta.

Zbritja për borxhet e dyshimta njihet kur ka dëshmi objektive që një të arkëtueshme e caktuar është e zhvlerësuar.

2.10 Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera janë të shprehura në vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

2.11 Njohja e te hyrave

Të hyrat përfaqësojnë të ardhurat e arkëtueshme nga aktivitetet kryesore të njësisë ekonomike duke përfshirë tarifën e transferimit për shitjen e lojtarëve të regjistruar dhe tatimin mbi shitjen.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshmeve dhe përfaqësojnë shumën e arkëtueshme për mallrat dhe shërbimet e ofruara në rrjedhën normale të biznesit.

2.11.1 Faturat e hyrjes në stadion-të ardhurat nga ndeshjet e ditës

Të ardhurat e lojës së ditës njihen me ndeshjet e luajtura gjatë gjithë vitit dhe pranohen vetëm atëherë kur ka përfunduar ndeshja.

Të ardhurat e ndeshjes së ditës që janë marrë paraprakisht në fund të vitit, por kanë të bëjnë me vitin e ardhshëm (p.sh. Shitjet e biletave sezonale) duhet trajtuar si të ardhura të shtyra dhe regjistrohen si teardhura për ndeshje që s'kanë përfunduar.

2.11.2 Sponzorizimi dhe reklamimi

Sponzorizimi dhe reklamimi përfshijnë sponzorët kryesore, sponzorët e tjerë, perimetrit e ndeshjeve dhe reklamimi i bordit, si dhe sponzorizimin dhe reklamimi të tjerë.

2.11.3 Të drejtat e transmetimit

Të ardhurat nga të drejtat e transmetimit përfaqësojnë të ardhurat e arkëtueshme nga kontratat e mediave vendore. Shpërndarjet në lidhje me performancën e ekipit njihen kur ato bëhen të sigurta.

2.11.4 Të hyrat operative

Të ardhurat operative përfshijnë të hyrat nga veprimtaritë e regjistruara të Kompanisë dhe të ardhurat tjera vetëm nëse nuk kategorizohen ndryshe.

2.11.5 Solidariteti i UEFA dhe çmimi i parasë

Çmimi i parasë së UEFA paraqet të hyrat e arkëtueshme nga pjesëmarrja në garat e UEFA-s.

Tregtimi dhe pagesat e participimit llogariten si shpenzime të ndeshjeve individuale.

Shpërndarja në lidhje me performancën e ekipit njihet vetëm atëherë kur llogaritet që është bërë për atë qëllim.

2.11.6 Të hyrat tjera

Të ardhurat tjera përfshijnë donacionet, grantet, mirpo asnjë të ardhur të jashtëzakonshme operative dhe të hyra të tjera të pa përfsira në kategoritë e tjera.

2.12 Zotimet dhe kontingjencat

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato zbulohen vetëm nëse mundësia e rrjedhjes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një pasuri kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloset kur një fluks i përfitimeve ekonomike është i mundshëm. Shuma e një humbjeje kontingjente njihet si një provizion nëse është e mundur që ngjarjet e ardhshme do të konfirmojnë se një detyrim i shkaktuar si në datën e pozicionit financiar dhe një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes që rezulton, mund të bëhet.

3. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	2023 €	2022 €
Paraja në arkë	252,941	337,538
Paraja në bankë	8	2,314
Depozitat afatshkurta bankare	-	-
Totali	252,949	339,852

4. Të hyrat

	2023 €	2022 €
Te hyrat nga donacionet dhe sponsorizimet	925,518	896,073
Te hyrat nga FFK	724,796	307,948
Te hyrat nga UEFA	3,451,919	3,884,136
Te hyrat nga shitjet e biletave	132,425	159,232
Te hyrat tjera - te drejtat televizive, reklama	46,301	10,051
Te hyrat nga shitja e lojtarve	582,985	-
Totali	5,863,944	5,257,440

5. Shpenzimet e Personelit-Pagave

	2023 €	2022 €
Paga Bruto	2,162,944	1,827,390
Kontributi i punëdhënësit	93,471	62,147
Kontributi i punëtorit	93,471	62,147
Tatimi në paga	192,550	162,881
Paga neto	1,876,923	1,602,362
Paga Bruto & Kontributi i punëdhënësit	2,256,414	1,889,537

6. Shpenzimet Administrative

	2023	2022
	€	€
Shpenzimet e zyres	90,956	12,216
Shpenzimet e reklames	3,525	7,609
Shpenzimet Mjekimore	3,616	6,271
Materiale	65,507	
Reprezentacion		
Total aktivite & operative	163,604	26,096

7. Shpenzimet e Aktiviteteve Sportive

	2023	2022
	€	€
Paisje Sportive	51,439	56,997
Gjyqtaret-Vezhguesit	4,300	5,470
Shpenzimet e Akomodimit	120,045	137,201
Shpenzimet e Udhetimit	499,804	219,051
Transfere te lojtarve	102,206	955
Shpenzimet e Ushqimit	33,441	14,787
Shpenzimet e shtypjes se biletave	27,714	19,061
Total aktivite & operative	838,948	453,521

8. Shpenzimet e Aktiviteteve Operative

	2023	2022
	€	€
Shpenzimet e Mirmbajtjes	55,431	68,226
Shpenzimet e Sigurimit	29,779	32,183
Shpenzimet e Sigurimit te automjeteve	-	792
Shpenzimet tjera operative	5,512	19,008
Total aktivite & operative	90,723	120,209

9. Ngjarjet pas datës raportuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim ose shpalosje në pasqyrat financiare.